

**STATUTI**  
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"Tailorsan Albania" SHPK**

Ne date 28/02/2022 ne Tirane, themelohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me ortak te vetem:

- **Z. Fiqiri Allmuca**, shtetas shqiptar, i lindur ne Tirane, Shqiperi me 29.09.1969, me banim ne Tirane, i pajisur me karten e identitetit n. 034215411 dhe nr. personal G90929156A, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Qe harton dhe nenshkruan Statutin qe vijon te shoqerise:

**Kreu 1**

**Themelimi, Emertimi, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e nenshkrimit, emertimi dhe ortakët**

1. Data e nenshkrimit te ketij Statuti eshte ne 28/02/2022 dhe emertimi i Shoqerise eshte "Tailorsan Albania" shpk, e themeluar ne formen e personit juridik me pergjegjesi te kufizuar.
2. Ortak i vetem i shoqerise eshte **Z. Fiqiri Allmuca**, shtetas shqiptar, i lindur ne Tirane, Shqiperi me 29.09.1969, me banim ne Tirane, i pajisur me karten e identitetit n. 034215411 dhe nr. personal G90929156A, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

**Neni 2**

**Objekti**

Objekti i veprimtarise do te jete:

Shitja, tregtimi, qiradhenia dhe mirembajtja, transporti I impanteve sanitare te levizshme, kimike dhe ekologjike, ose we te levizshme, pastrim, dezinfektim, dozifektim I banjove te levizshme ose fikse dhe te strukturave te tjera publike dhe private;

Realizimi, shitja dhe tregtimi I produkteve per higjenen mjedisore ose komunitare me te gjitha njesite te levizshme ose fikse.

Sherbime pastrimi dhe mirembajtje te impianteve te brendshem dhe te jashtem, industriale dhe civile, publike dhe private. Pastrim te perditshme, pastrime speciale, pastrime pas ristrukturimit, lysterjes etj. Lavazh, pastrim, trajtim dhe lubifikim te dyshemeve te cdo lloji dhe te cdo lartescie. Pastrim dhe lavazh i kolltukeve, divaneve, karrigeve, tapeteve, moketeve, tendave te kolla dhe te trasha, grilave etj., te cdo lloji dhe permase.

Sherbime lavanderie dhe hotelerie, larje, hekurosje te cdo lloji dhe transport i materialeve te pastra. Sherbime autolavazhi per cdo llok mjete. Pastrim dhe dizinfektim (DDD) te strukturave spitalore te brendshme dhe te jashtme me rrezik te ulet, te mesem dhe te larte. Vleresim i impaktit mjedisor dhe audit mjedisor, hartim i akt ekspertimeve, raporteve etj. Tregtim (Shitblerje), fumizim, importim me shumice dhe pakice te detersiveve, produkteve, materialeve, pajisjeve, veglave, aksesoreve, makinave te pastrimit. Sherbim mirembajtje gjelberimi dhe bimeve zbukuruese, krasitje, mbjellje dhe zevendesim lulesh, bimesh dhe pemesh. Transport mallrash dhe produktesh per ente te ndryshme. Transport, grumbullim dhe heqje e mbetjeve urbane, pastrim qyteti, fshati etj., dhe trajtimin e riciklimin e mbetjeve. Grumbullim, transport dhe heqje e mbetjeve spitalore dhe mbetjeve spitalore te rrezikshme. Realizimin dhe mirembajtjen e impianteve per djegien e mbetjeve, Trajtimin dhe djegien e mbetjeve urbane dhe spitalore. Riperdorimin e materialeve, makinerive, paketim dhe prodhim i lendeve djegese nga mbetjet Pastrim me mjete teknike te posacme uji, transport i materialeve te pastra. Pastrim i gropave septike te cdo lloji dhe transportin e ujrave te zeza. Sherbim i Nderhyrjes Higjieno – Sanitare. Sherbim



Dizinfektimi (DDD – Dizinfektim – Dezinsektim – Deratizim) – te cdo lloj mjedisi te brendshem dhe te jashtem, publik dhe privat, te spitaleve dhe qendrave shendetesore te cdo lloj subjekti; heqjen e gjarperinjve, qenve, maceve, minjve te fshatit, mizave dhe insekteve, pemeve dhe bimeve. Importimin dhe tregtimin e produkteve per trajtimin DDD dhe heqjen e gjarperinjve, qenve, maceve etj. Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te pesticideve (PPP). Prodhim dhe tregtim me shumice dhe pakice te farerave, bimeve, luleve etj. Trading (shitblerje), import, qiradhenie te vincave per ngritjen e peshave, autoklavave, makinerive per ngritje, vincave me kosh dhe cdo lloj platforme ajrore tjeter. Sherbime per lysterjen, patinimin, stukimin ne cdo lartesi. Ndertime civile dhe ekonomike, ristrukturim te ndertesave deri ne 5 kate. Pastrim i impianteve te aspirimit – kondicionimit (HVAC – Ngrohje, Ventilimi dhe Kondicionimi), kapat e kuzhines, pajisjeve te impianteve industriale dhe restoranteve, hoteleve, lavanderive (larje e thate), qendrave tregtare, spitaleve, apartamenteve dhe banesave private etj. Sherbime elektrike dhe tregtimin e materialeve elektrike. Sherbime hidraulike dhe tregtimin e materialeve hidraulike, ndertimin dhe ristrukturimin e ndertesave publike dhe private, rikonstruksionin dhe mirembajtjen e te gjitha impianteve, duke perfshire segmentet rrugore, mirembajtjen e ndertesave publike dhe private, shitjen dhe furnizimin e aparaturave dhe materialeve per impiante elektrike, laboratorit, spitali, me shumice dhe pakice.

Per realizimin e veprimtarise dhe arritjen e qellimit, shoqeria mund te ushtroje veprimtari te tjera: cdo lloj operacioni tregtar, industriale dhe financiar, te luajtshem dhe te paluajtshem, duke perfshire ndertimin, shitjen dhe administrimin e pasurive te paluajtshme qe lidhen me objektin e veprimtarise. Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj kryerjen e cdo operacion ekonomik dhe ligjor te lejuar nga legjislacioni shqiptar, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj dhe qe do te jene te rendesishme per te ardhmen e shoqerise.

### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje alat te pacaktuar.

### **Neni 4**

#### **Selia qendrore**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Sheshi Skenderbej, Pallati i Kultures, kati 3, zyra 56; 1000, Tirane, Shqiperi.

### **Kreu II Kapitali**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali fillestar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.200.000 Leke (nje milion e dyqind mije leke) i nenshkruar nga ortaku i vetem, Fiqiri Allmuca i cili zoteron 1 (nje) kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise.

#### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet permes nenshkrimit nga palet te kapitalit shoqeror me kontribute ne para dhe permes kontributeve ne natyre, pas emerimit nga ana e gjykates kompetente nje eksperti te autorizuar per keto kontribute me kerkese te administratorit.

Ne asnje rast maxhoranca nuk mund te detyroje nje ortak qe te rrise angazhimin e tij ne kapitalin e shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asamblea e ortakeve, qe vendos me te njejtat kushte te parashikuara per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ortaket ne te njejtin mase, me pjeset e kapitalit qe perfaqesojne.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe te drejtat qe burojne mund te blihen ose transferohet permes:

- i. Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- ii. Shitblerjes
- iii. Trashegimise
- iv. Dhurimit
- v. Cdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.

Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te transferohen lirisht mes ortakeve, pervec kur parashikohet ndryshe nga statuti. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme me trashegimi.

Keshilli i administrimit do te mblidhet te paktën 2 (dy) herë në vit, në të cilin Administratori do të raportojë për ushtrimin e perfaqesimit.

#### **Kreu III**

##### **Organet vendimmarrese dhe te administrimit**

#### **Neni 8**

##### **Organi vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas menyrave te parashikuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine ne ceshtjet e meposhtme:

- a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. Ndryshimet statutore
- c. Emerimin dhe revokimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe revokimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te miratuar.
- e. Percaktimin e shperblimeve per subjektet e parashikuara ne germat "c" dhe "d" te kesaj dispozite
- f. Mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga ana e administratoreve, perfshire dhe hartimin e paqyrave financiare vjetore si dhe te raporteve mbi performancen.
- g. Miratimin e bilanceve vjetore dhe te raporteve mbi performancen.
- h. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- i. Shperndarjen e kuotave dhe anullimin e tyre.
- j. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykim dhe ne procedime te tjera kunder administratoreve.
- k. Riorganizimin dhe shkrirjen e shoqerise.
- l. Miratimin e rregollores procedurale per mbledhjet e asamblese.
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji ose statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble, me autorizim nga nje ortak tjeter ose nje i trete. Autorizimi mund te jepet per nje mbledhje te vetme te asamblese se pergjithshme, qe perfshin edhe mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

#### **Neni 9**

##### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**



Asambleja e Pergjithshme thirret me njoftim me shkrim ose me email. Njoftimi me shkrim ose elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites qe duhet ti dergohet te gjithe ortakeve brenda dhe jo me vone se 7 dite perpara dates te parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur asambleja e pergjithshme nuk thirret sipas pikes 1 te ketij neni, mund te merren vendim te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendim, megjithe parregullsite.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendim te vlefshme vetem me 100% te votave te ortakeve (ne cilesine e ortakeve qe marrin pjese ne kete asamble sic parashikohet nga neni 10) ne lidhje me:

- i. Ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te shoqerise, shperndarjen e fitimit, riorganizimin dhe shperndarjen e shoqerise;
- ii. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- iii. Emerimin dhe revokimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- iv. Percaktimin e shperblimeve;
- v. Zbatimin e politikave tregtare nga ana e administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te performances;
- vi. Perfaqeson shoqerine ne gjykim dhe ne procedime te tjera kunder administratoreve;
- vii. Miraton rregulloren e brendshme te mbledhjeve te asamblese;
- viii. Si dhe cdo akt tjetër, rregullorë dhe/ose ceshtje qe nuk eshte parashikuar ketu shprehimisht por qe eshte subjekt rishikimi dhe miratimi nga ana e Asamblese se Ortakeve.

Cdo ndryshim i statutit duhet te depozitohet prane regjistrimit tregtar per te pasqyruar ndryshimet ne dosjen e shoqerise.

#### **Neni 12**

##### **Administrimi**

1. Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizik si administratore te shoqerise. Kohezgjatja e detyres eshte 5 vjet, me te drejte rinovimi. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te regjistrimit.
2. Administratoret e nje shoqerie kontrolluese, sipas percaktimeve te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen administratore te nje shoqerie te kontrolluar apo anasjelltas. Cdo emerim i kryer ne shkelje te kesaj dispozite eshte e pavlefshme.
3. Administrator i Shoqerise emerohet **Z. Fiqiri Allmuça**, shtetas shqiptar, i lindur ne Tirane, Shqiperi me 29.09.1969, me banim ne Tirane, i pajisur me karten e identitetit n. 034215411 dhe nr. personal G90929156A, i cili ka te gjitha te drejtat e perfaqesimit te shoqerise dhe pa asnje kufizim te kompetenceve;  
Administratori eshte emeruar per nje periudhe 5 vjecare, me te drejte rizgjedhjeje.

#### **Neni 13**

##### **Tagrat e administrimit**

Administratori ka te drejten dhe detyrimin qe:

- i. Te kryeje te gjitha aktet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te percaktuara nga asambleja;
- ii. Te perfaqesoje shoqerine;
- iii. Te kujdeset per mbajtjen korrekte dhe te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise dhe te garantore perdorimin e rregullt te sherbimit internet – banking nga ana e te gjithe ortakeve te shoqerise;



- iv. Te hartojë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe relacionin mbi ecurinë e veprimtarisë dhe, bashkarisht me propozimet për shpërndarjen e fitimit, të ja nënshtrorë këto dokumenta për miratim asamblese së përgjithshme;
- v. Te krijojë një sistem të shpejtë alarmi për rrethanat që kërcënojnë ecurinë e aktivitetit dhe ekzistencën e sipërmarrjes;
- vi. Te kryejë regjistrimet dhe të dergojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- vii. Të raportojë asamblese së përgjithshme mbi zbatimin e politikave tregtare dhe mbi zbatimin e veprimeve më të rëndësishme të vecanta për veprimtarinë e shoqërisë;
- viii. Te kryejë çdo gjë tjetër të parashikuar nga ligji dhe statuti.

Administratori ka për detyrë të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor dhe raportit financiar të ndërmjetem, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk mbulon pasivitetet e kërkueshme brenda 3 muajve të ardhshëm.

Nëse asambleja emëron më shumë administratorë, këta administrojnë shoqërinë në mënyrë të pavarur. Asambleja e Përgjithshme mund të revokojë administratorin në çdo moment sipas procedurës të parashikuar në nenin 11 të Statutit. Çështjet në lidhje me shpërblimin e administratorit, mbi bazën e marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 14**

##### **Përgjegjësia e administratorit**

Administratori është personalisht përgjegjës, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljet e ligjit, për shkeljet e statutit ose për veprat penale të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë janë në ngarkim të administratorit.

Përveç sa parashikohet në dispozitat e përgjithshme mbi detyrimin e mirebesimit, në bazë të neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori ka detyrimin që:

- a) Të përmbushë detyrimet e parashikuara nga ligji dhe statuti në mirebesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecante ndikimit që veprimtaria e shoqërisë ka në mjedis;
- b) Të ushtrojë kompetencat e njohura nga ligji dhe statuti vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- d) Të parandalojë dhe shmangë raste konflikti, ekzistues ose potencial, të interesave personale me ato të shoqërisë;
- e) Të ushtrojë funksionet e tij me kujdesin dhe profesionalitetin e nevojshëm.

2. Administratori, në ushtrimin e funksioneve të tij, është përgjegjës ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet me qëllimet e shoqërisë, përveç kur, mbi bazën e hetimit dhe vlerësimit të informacioneve të rëndësishme, veprimi ose mosveprimi është bërë në mirebesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, në bazë të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të demshperblejë shoqërinë për dëmet e ardhura nga shkelja e kryer, si dhe të demshperblejë çdo përfitim personal që ai apo persona të lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta. I përket administratorit barra e provës për të verifikuar ushtrimin e funksioneve në mënyrë të rregullt dhe sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga disa administratorë, ata përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë.

4. Në vecanti, por pa u kufizuar në të, administratori ka detyrimin që të demshperblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryen këto veprime:

- a) i kthen kontributet ortakeve;

- b) interesat ose dividenti I paguhet ortakeve;
- c) jane shpermdare sende te shoqerise;
- d) i mundeson shoqerise qe te vijoje aktivitetin e saj tregtar, kur mbi bazen e situates te saj financiare, do te duhej te ishte parashikuar qe shoqeria nuk ishte ne gjendje qe ti bente balle detyrimeve te saj.
- e) jep kredi.

Percakteshet per shperblimin e demeve qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket vete ose bashkarisht, kane te drejte qe te ndermarrin aksione penale kunder administratorit.

#### **Kreu IV**

##### **Viti financiar – Ekspertet**

#### **Neni 15**

##### **Viti financiar**

Veprimtaria financiare e shoqerise fillon ne 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i par financiar fillon nga dita e regjistrimit te shoqerise ne Qendren kombetare te regjistrimit dhe perfundon me 31 dhjetor.

#### **Neni 16**

##### **Ekspertet**

Eksperti ka detyren qe te verifikojte te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike dhe tregtare te shoqerise, ate vjetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te kryera prej tij ne raste kur, ne baze te kerkeses se ortakut, i ka kryer.

Ne perfundim te revizionit kontabel, eksperti kontabel i miratuar harton raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar te vitit si dhe per kontrollet periodike qe ka detyrimin qe ti paraqese brenda nje afati te arsyeshem ortakeve, per shqyrtim dhe miratim sipas ligjit.

#### **Kreu V**

##### **Shperndarja – Riorganizimi i shoqerise**

#### **Neni 17**

##### **Shperndarja dhe likuidimi**

Shperndarja e shoqerise mund te behet ne cdo moment:

- a) Kur perfundon afati i parashikuar ne momentin e themelimit;
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) Me celjen e procedurave te falimentit;
- d) Nese nuk ushtron aktivitet tregtar prej dy vitesh dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I aktivitetit ne baze te nenit 43, pika 3, e ligjit 3.5.2007, n. 9723 “Per qendren kombetare te regjistrimit”
- e) Me vendim gjyqesor.

Ne kete rast, ortaket marrin nje vendim me shkrim ne te cilen pasqyrojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke emeruar 1 ose me shume likujdues dhe duke nenshkruar cdo akt te nxjerre prej tyre, ne emer te likujduesit me titullin “Shoqeri ne likujdim e siper”.

Shperndarja e shoqerise sjell celjen e nje procedure likuidimi ne gjendje likuiditeti, pervec rasteve kur ka filluar nje procedure falimenti.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket. Nese ortaket nuk shprehen mbi emerimin e likujduesve, brenda 30 diteve nga shperndarja, cdo i interesuar mund ti drejtohet gjykates per emerimin e nje kuratori.



**Neni 18**

**Riorganizimi i shoqerise**

Shoqeria mund te ndahet, shkrihet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne respekt te dispozitave ligjore te parashikuara nga Pjesa IX e Ligjit 9901, date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**Neni 19**

**Baza ligjore**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne respekt te ketij statuti dhe te dispozitave te legjislacionit shqiptar.

Pervec sa parashikohet nga ky statut, gjejne zbatim dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite", kodi civil dhe cdo ligj tjeter i Republikes se Shqiperise.

Ky statut prezumohet se perfshin ne te edhe aktin e themelimit.

**Neni 20**

**Marredheniet e punes**

Marredheniet e punes rregullohen nga Kontrata e Punes. Per ceshjet e paparashikuara ne to, do te zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise. Mosmarveshjet punonjesve me shoqerine do te zgjidhen nga gjykata shqiptare. Ortaket punonjes autonome gezojne te drejten e pages bashkarisht me te gjitha te drejta dhe detyrimet qe burojne nga Kontrata e Punes. Keto te drejta dhe detyrime jane te ndryshme nga te drejta dhe detyrimet qe rrjedhin nga qenia ortak ne shoqeri.

**Neni 21**

**Mosmarveshjet**

Gjykata shqiptare do te jete kompetente per cdo mosmarveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve.

Ky statut eshte nenshkruar me vullnetin e lire dhe te plote te ortakut te vetem.

**ORTAKET  
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"TAILORSAN ALBANIA" SHPK**

**Fiqiri Allmuca**

